



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË  
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr. 12/34 Prot

Gjirokastër më 21 : 12 :2023

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 14.12 .2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 14.12. 2023

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **14.12.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:05 Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë dhe i bashkohen mbledhjes Spartak Drasa, Adrian Novi dhe Fatjona Basha anëtarë . Z. Dashnor Qeli I cili është online. Gjithsej 25 anëtarë. Mungojnë në mbledhje; Rova, Çabeli, Aliko, Leskaj, Cacaj, Mahmutaj. Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes. Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës së bashku me 2 pikat shtesë të propozuar nga ekzekutivi

1. “Për Autorizimin e Bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për nënshkrimin e kontratës dhe implementimin e projektit të financuar nga UNESCO dhe HERALD”
2. “Për trajtim me bursë të nxënësve, për vitin 2023-2024”.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 04. 12.2023.
2. P/Vendim “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.
3. P/Vendim “Për miratimin e kalendarit të të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”.
4. P/Vendim “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në bashkinë Gjirokastër për vitin 2024”.
5. P/ Vendim “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”.
6. P/Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2024”.
7. P/Vendim “Për miratimin e dhënies së sipërfaqeve të tokave bujqësore me qira”
8. Të ndryshme.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi I ditës me pikat shtesë me 22 vota pro.

Miratohet me 22 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 04.12.2024.ZNJ. Isaraj: Propozoj që pikën 2 të rendit të ditës që ka të bëjë me buxhetin ta lëmë për në fund të mbledhjes dhe të vazhdojmë me pikat e tjera.

Hidhet në votë dhe miratohet propozimi I znj Isaraj.

Znj. Isaraj paraqet pikën 3 të rendit të ditës: P/Vendim “Për miratimin e kalendarit të të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”

Miratohet me 21 vota pro pika 3. Abstenim Erion Shehaj.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës:

Z. Llogo: E kemi kaluar në Komisioni e Ekonomisë dhe morëm informacion se arsyeja e shtimit të nr të punonjësve nga 621 në 641 është rritja e shërbimeve, rritja e performancës së shërbimeve utilitare dhe sektori i IT-së.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro

Kalohet te pika 5: P/ Vendim “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”.

Shprehet në emër të Komisionit të Shëndetësisë, Barazisë Gjinore dhe Çështjeve sociale z. Arianit Muho:

Maerialet kanë kaluar në komision dhe jemi shprehur dakord për trajtimin e tyre në mbledhjen e sotme.

Z. Brahimi: A nuk duhet të ketë komisioni përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe të Shoqërisë Civile?

Z.Nebij: Në zbatim të VKM Nr. 22/2018 përberja e komisionit parashikohet të jetë me 3 përfaqësues të bashkisë dhe 2 shoqëri civile, gjë e cila është zbatuar në material.

Miratohet pika 5 me 22 vota pro.

Hidhet në votë dhe miratohet pika 6 me 22 vota pro.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro pika 7 P/Vendim “Për miratimin e dhënies së sipërfaqeve të tokave bujqësore me qira”.

Kalohet te 2. “Për trajtim me bursë të nxënësve, për vitin 2023-2024” dhe miratohet me 22 vota pro.

Kalohet te pika 2 shtesë “Për Autorizimin e Bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për nënshkrimin e kontratës dhe implementimin e projektit të financuar nga UNESCO dhe HERALD”.

Sqaron znj. Jorida Muho në lidhje me këtë pikë

Pas aplikimit nga bashkia Gjirokastër për dy projekte të rëndësishme jemi shpallur fitues në dy projekte të cilat kanë të bëjnë : Ipari I mbështetur nga UNESCO dhe ka të bëjë me evidentimin

dhe mbështetjen e artizanëve me një vlerë 80 mijë euro kurse I I dyti ka të bëjë me lidhjen e marrëveshjeve për shkëmbime teatrale me teatrot publike të Pulias dhe të Podgoricës me një vlerë 36mijë euro.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro “Për Autorizimin e Bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për nënshkrimin e kontratës dhe implementimin e projektit të financuar nga UNESCO dhe HERALD”.

Znj. Isaraj Kalojmë te pika më e rëndësishme e mbledhjes:

Për Komisionin e Ekonomisë shprehet Z. Gentian Llogo. RELACION I KOMISIONIT TE EKONOMISE

Komisioni IFinancave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik imbledhur në datë 13.12.2023

Në lidhje me miratimin e PBA 2024-2026 vlen për tu theksuar se shpenzimet operative synohen të mbahen konstante në vlerën 1%-2%. Krahasuar me buxhetin vjetor 2023.

PBA parashikon shpenzime në shërbimet kryesore si”

- Infrastrukturë arsimore
- Inrastrukturë rrugore
- Menaxhim I pyjeve dhe kullotave

Për PBA 2024-2026 janë parashikuar shpenzime për projektë në vlerën 32.590.000.

Në zhpenzimet kapitale vlera totale parashikohet 304.989.0000 lekë ku pjesën më të madhe e zënë ;

1. Rikonstruksioni I objekteve arsimore.
2. Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe në ndriçim.

Krahasuar me 2023 ku shpenzimet kapitale ishin në vlerën 269.769.0000 është planifikuar rritja me 9.7%.

Synimi I PBA

- Mbështetja dhe menaxhimi i nfrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.
- Mbështetja e e administrimit të pyjeve dhe kullotave.
- Mbështetja e rrjetit rrugor në Njësitë Administrative dhe ndriçimi.
- Menaxhimi I mbetjeve.
- Mbështetja për arsimin.

- Mbështetja për sigurinë publike ku bëjnë pjesë zjarrfikësja, Policia vendore dhe Emergjencat Civile.

Në buxhetin vjetor 2024 parashikim I shpenzimeve është fokusuar në :

1. Rritja e performancës në shërbimet komunitare utilitare sipas zërave:

Menaxhim i mbetjeve

Ndriçimi rrugor

Shtimi i hapësirave të gjelbra

Zgjerimi i zonave që mbulohe me ndriçim në njësitë administrative

2. Mbështetja për arsimin e cila synon në mbështetjen financiare për funksionim normal IA-ve. Trajtimi ushqimor në kopshte dhe çerdhe

Ngrohja

Akordimi I bursave.

Mbështetja sociale

Ku bëjnë pjesë ndihma ekonomike

Mbështetja për shtresat në nevojë

Funksionimi I qendrës ditore .

Subvencioni I qirasë etj

Mbështetja e sektorit të pyjeve kullotave me parashikimin e shpenzime per projekte në këtë fushë me qëllim menaxhimin e hapësirave kullotore , rikonstruksion e ndërtim lerash , kanalesh me qëllim funksionimin e ujitjes dhe kullimit. Mbështetja për turizmin, artin , kulturën, trashgiminë dhe sportet .Promovim I trashëgimisë kulturore, zhvillimi I aktiviteteve me qëllim promovimin e saj. Mbështetje financiare në fushën e turizmit .Mbështetje për zhvillimin e shfaqjeve tatrale dhe kinemasë. Mbështetja e sportit dhe rritja e nr të disiplinave sportive si shah, basketball, bodybuilding, aeronautikaPërfundimish sipas planifikimit të ekzekutivit buxheti 2024 parashiko 809.274.000 lekë të ardhura të pritshme në vlerë 16% më shumë se planifikimi I 2023, ku edhe nga transferta e kushtëzuar nga pushteti qëndror vlera shkon në shifrën 541.175.000 ose 9.8% më shumë se në vitin 2023.

Shpenzimet operative për vitin 2024 janë parashikuar në vlerën 662.413.000, ku shpenzimet janë rritur më 11.2 % , rritje e cila kushtëzohet edhe nga rritja e pagave bazuar në VKM E VITIT 2023, 3 rritje si dhe rritja e çmimit të ushqimeve që kanë të bëjnë me trajtimin ushqimor.

Shpenzimet kapitale janë parashikuar në vlerën 113.720.0000 kraasuar me 2023 36% më shumë Ku fokusi te këto shpenzime është

Infrastruktura shkollore, rrjeti rrugor rural dhe ndriçimi të cilat I përmendëm dhe më lart.

Buxheti I vitit 2024 zbatohet në 7 programe dhe 24 funksione.

Vijnë në mbledhje Adrian Novi, Spartak Drasa

Prezantohet në PP nga drejtoriae financës materiali. P/Vendim “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Znj. Koko prezanton planifikimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024 duke paraqityr synimet dhe mënyrën e realizimit të tyre.

Si pasojëe projektit të ndriçimit Bashkia Gjirokastër ka ulur me 50% vlerën e shpenzimeve për ndriçim.

Znj. Artiste Koko; Paraqet para këshillit prezantimin në PP të PBA 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024.

Bashkia gjirokastër e zbaton buxhetin bazuar në 7 programe, 24 funksione dhe 74 produkte. Shpenzimet janë të bdara në : Shpenzime për paga në vlerën 507.087.000 lekë, shpenzime operative në vlerën 188.467.000 dhe shpenzimet kapitale në vlerën 113.720.000 Lekë. Sipas kodeve përkatëse funksionojnë 7 programet që janë

Aparati dhe menaxhimi I Bashkisë,  
Shërbimi Social Shendetësor,  
Turizmi, Trashëgimia.  
Arti, Kultura dhe sportet,  
Siguria Publike  
Shërbimet Komunitare dhe Utilitare

ZNJ. Koko;sqaron për të gjitha programet dhe shërbimet që ofron bashkia shpenzimet buxhetore dhe burimet e financimit

ZNJ. Merita Isaraj: Falënderon znj. Koko për paraqitjen e detajuar të materialit në PP.

Kalohet në pyetje rreth materialit: Erion Shehaj

Ku janë bërë dëgjesat publike?

z. Golemi: Bashkia në bashkëpunim edhe e Këshillin ka realizuar Dëgjesat Publike në të gjitha njësitë administrative dhe në qytet me grupet e interest.

Kemi mbajtur shënim çdo kërkesë të qytetarëve dhe mbase nuk kemi buxhetin që do donim, por kemi buxhetin që ne mundemi të zbatojmë

Parashikojmë një buxhet në vlerë 113 milion lekë, ose 300 milion më shumë se vitin e kaluar Jemi të fokusuar të investimet për mbrojtjen e mjedisit ku kemi edhe mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit në pjesën e menaxhimit të mbetjeve , impiantin e ujërave të zeza

Investime në infrastrukturë ku përveç investimeve në IA me fondet e bashkisë, do të kemi mbështetjen e USAID dhe UNICEF për tre vitet e ardhshme në 10 shkolla në qytet dhe në njësitë administrative.

Do vazhdohet me investimet për modernizimin e ndriçimit public. Kemi filluar në 17 fshatra dhe do ta zgjerojmë hartën e këtij shërbimi.

Do të vazhdohet në lagjet e qytetit në zbatim të Plnit të Mobilitetit.

Do të vazhdohet me rrugët rurale, ndërhyrja në vazhdim në rrugën e Zhulatit dhe projekti për rrugën Kolonjë -Golem.

Ngelet problem terminali I qytetit , I cili do të ketë nevojë për shpronësime.

Aerporti na ndryshoi gjithë planin qëkishim për te NSHN-ja.

Ndërhyrja në lera , rikonstruksion dhe lera të reja

Projekte për menaxhimin e pyje kullotave .Gjithashtu kemi kërkuar shtim të nr të punonjësve për të ku nga sektor kemi menduar te krijojmë Drejtorinë e Projekteve pasi ka rezultuar sukses pjesëmarrja dhe jemi shpallur të dytet në rang vendi përprojektet e fituara.

Z. Adrian Novi: Ju faleminderit për risitë e planifikuara në buxhet.

Qyteti ynë ka kalanë dhe pjesa më e madhe e të ardhurave të kalasë administrohet nga Ministria e Kulturës, Gjirokastra në 10 vitet e ardhshme do kete rritje me disa herë të vizitorëve në kala. A

mund të bëhemi aksionerë me Ministrinë e Kulturës për të marrë një % të të ardhurave nga kjo ministri?

Z. Golemi: Sigurisht që do të donim të merrnim pjesë të të ardhurave, por është në administrim të Ministrisë së Kulturës. Ta shohim nga ana juridike dhe me mbështetjen tuaj të hartojmë një kërkesë.

Shpronësimet janë bërë pengesë edhe për zbatimin e projekteve.

Z. Drasa. Në vitin 2007 është zhvilluar një process gjyqsor ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Gjirokastrë për të ardhurat e kalasë dhe kemi dalë me humbje. Nuk e di si do ta realizoni këtë gjë. Përsa i përket investimeve në qendrën historike a janë parashikuar në buxhet? Është problem rruga nën kala , rruga të Drejtoria Arsimore, fasadat dhe rruga te hotel” Kalemi”. A janë parashikuar investime nga bashkia?

Z. Golemi : Me Planin e Mobilitetit do të vazhdohet ndërhyrja në lagjen “ Palorto” dhe rruga poshtë kalasë. E kemi të qartë ku është problem, te rruga mbi bashkinë e cila ka bërë një ulje rreth gjysmë metrë. Kemi kërkuar ndihmë dhe jemi në bisedime edhe me Bankën Botërore dhe me Ministrinë e Kulturës , sepse përgjegjëse nuk është vetëm bashkia Gjirokastrë, pasi kalaja është pasuri botërore.

Z. Novi: Të ardhurat e kalasë duhen përdorur për të gjithë ndërhyrjet që duhen në qytet.

Z. Petrit Brahim: Ju përgëzoj për punët e mira dhe materialin e paraqitur, rritja me 16% e të ardhurave tregon për punë të mira sepse çdo e ardhur është një investim më shumë dhe shërbime më të mira. Ju del punë më emadhe në realizimin e të ardhurave sepse nga ato varet realizimi i buxhetit. Një nga problemet më të mprehta që shoh janë shpronësimet. Shikoni rrugën te tuneli ne lagjen Palorto, duhet shpronësuar ato dy ndërtesat në shërbim të zgjerimit të rrugës.

Ndërhyrje kërkojnë edhe rrugët rurale, rruga Topollaraj -Arshi Lengo ju hyn në punë fermerëve. Me ndriçimin public janë bërë punë të mira dhe të vazhdohet më tej, shpreh dakortësinë time për vazhdimin e zbatimit të projektit të rrugës së fshatit Zhulat dhe për fillimin e rrugës së fshatit Golem.

Falënderoj zyren e projekteve për projektet e fituara. Është një buxhet ambicioz dhe shpreh votën time pro.

Hidhet në votë dhe miratohet me 23 vota pro dhe dy abstenime P/ Vendim “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Mbyllet mbledhja në orë 13;25 nga znj Isaraj.

**Sekretar i Këshillit**  
**Etleva Yzo**

**Kryetar i Këshillit**  
**Merita Isaraj**